

Përfundimi i anëtarësisë në SHSHP

1. Një anëtar mund të përjashtohet nga SHSHP për qëndrim dhe sjellje të dëmshme ndaj objektivave dhe qëllimeve të SHSHP-së ose kur ai nuk i përmbahet statutit apo rregullave të SHSHP-së.
2. Përjashtimi i një anëtari vendoset nga Mbledhja e Përgjithshme e SHSHP-së me rekomandim të Këshillit Drejtues, rekomandim në të cilin paraqiten arsyet ku bazohet propozimi.
3. Një anëtar konsiderohet se është i rregullt në qoftë se ka paguar plotësisht brenda afateve të përcaktuara të gjitha kuotat e kontributet e anëtarësisë.
4. Një anëtar mund të japë dorëheqjen nga SHSHP në çdo kohë nëpërmjet dorëzimit të dorëheqjes së tij me shkrim në selinë e SHSHP-së.
5. Përgjegjësia e anëtarit që largohet është e njëjtë me atë të anëtarëve të tjerë të SHSHP-së për veprimtarinë e kryer deri në çastin e largimit. Anëtari që largohet duhet të shlyejë paraprakisht të gjitha detyrimet që ka ndaj SHSHP-së. Çdo mosmarrëveshje në këtë drejtim, nëse nuk zgjidhet me mirëkuptim, zgjidhet në gjykatë.